

Çfarë duhet të dini për kancerin e zorrës së trashë

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Kanceri i zorrës së trashë është shkaku i dytë kryesor i vdekjes nga kanceri në SHBA. E mira është se depistimet mund të parandalojnë kancerin e zorrës së trashë ose të ndihmojnë në zbulimin e hershëm të tij, kur dhe është më i lehtë për t'u trajtuar.



Çfarë është kanceri i zorrës së trashë?

Kur formohen masa të vogla (të quajtura polipe) në muret e brendshme të zorrës së trashë ose rektumit, ato mund të zhvillohen në kancer.



Kur duhet të depistohem?



Depistimi i rregullt mund të parandalojë kancerin e zorrës së trashë. **Nëse jeni 45 vjeç e lart**, flisni me mjekun për depistimin e kancerit të zorrës së trashë edhe nëse ndiheni mirë me shëndet. Nëse jeni në rrezik të lartë nga kanceri i zorrës së trashë, mjeku mund t'ju rekomandojë të filloni ekzaminime të rregullta përpara se të bëheni 45 vjeç.

1 NË 20 NJERËZ DIAGNOSTIKOHEN ME KANCER TË ZORRËS SË TRASHË GJATË JETËS SË TYRE



Cilat janë simptomat e kancerit të zorrës së trashë?

Shumica e njerëzve me polipe dhe kancer të zorrës së trashë nuk kanë simptoma. Flisni me mjekun nëse keni:

**DHIMBJE NË STOMAK
OSE BARK**




SHTIM TË GAZRAVE NË ZORRË



**NDRYSHIME NË
TRASHËSINË APO
FORMËN E FEÇEVE,
SIDOMOS NGÛSHTIM**



RËNIE NË PESHË



GJAK NË FEÇE



**KAPLLËK APO
DIARRE E RE**



Si të depistohem për kancer të zorrës së trashë?

Ka shumë mënyra për t'u depistuar për kancer të zorrës së trashë. Dy kryesoret janë **një analizë e feçeve e quajtur FIT** ose kolonoskopia.

Depistimi i hershëm dhe i rregullt paraqet probabilitet më të lartë mbijetese.

9 në 10 njerëz mbijetojnë nga kanceri i zorrës së trashë i zbuluar që herët



Vetëm 1 në 10 njerëz mbijetojnë nga kanceri i zorrës së trashë i zbuluar me vonesë



Çfarë është FIT?

FIT ose analiza imunokimike e fekaleve (Fecal Immunochemical Test), është një analizë e feçeve që kryhet në shtëpi dhe që kontrollon për prani gjaku në feçe.

- + Do t'ju duhet ta sillni mostrën e feçes në klinikë ose ta dërgoni me postë në një laborator për analiza.
- + Analiza e feçeve duhet kryer çdo vit, për sa kohë që rezultatet i keni normale.
- + Nëse zbulohet prani gjaku në mostrën tuaj, mund të duhet të kryeni kolonoskopi.

Çfarë është kolonoskopia?

Kolonoskopia është një procedurë ku mjeku fut një tub elastik me dritë në rektumin tuaj për të kontrolluar për shenja kanceri. Mjeku mund të gjejë dhe heqë shumicën e masave të vogla dhe disa lloje kanceri.



Çfarë mund të pres nëse mjeku më rekomandon kolonoskopi?

- + Përgatitja e duhur përpara kolonoskopisë është shumë e rëndësishme. Ndiqni me kujdes udhëzimet nga mjeku.
- + Mosndjekja e këtyre hapave mund të sjellë përsëritjen e tyre dhe riplanifikimin e kolonoskopisë.
- + Kolonoskopitë kërkojnë qetësues ose anestezi të lehtë. Do t'ju duhet të vijë dikush t'ju marrë pas vizitës.
- + Mjeku do t'i diskutojë me ju rezultatet e kolonoskopisë. Ai do t'ju thotë gjithashtu se kur të kryeni kolonoskopinë vijuese.


Si mund t'i reduktoj gjasat e pësimit të kancerit të zorrës së trashë?

Bërja e një jete të shëndetshme mund të reduktojë gjasat e pësimit të kancerit të zorrës së trashë.

KUFIZONI MISHIN E PËRPUNUAR NË DIETË




KUSHTOJINI VËMENDJE PESHËS SUAJ



USHTROHUNI RREGULLISHT



LINI DUHANIN



KUFIZONI KONSUMIN E ALKOOLIT



Nëse jeni 45 vjeç e lart dhe nuk jeni depistuar për kancer të zorrës së trashë, flisni me ofruesin tuaj të kujdesit primar ose telefononi në nr. **1-844-692-4692** për të lënë takimin tuaj sot!

Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Telefononi për të lënë një takim
1-844-NYC-4NYC
1-844-692-4692



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

nychealthandhospitals.org

Albanian 03/22